REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno / Prejato / Recieved / Delivery 21. 01. 2019 vitl god year

Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRMSHCK	328/2019		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.824/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Lela Petkoviç dhe Malsore Gashi–Bajraktari- anëtar dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr. 824/2018, të datës 12.12.2018 të parashtruar nga ankuesi Tahir Hysenaj, me adresë banimi rruga "Afrim Hyseni'', Nr. 27, në Komunën e Istogut, kundër organit të punësimit/Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "Kompensim material'', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.01.2019, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.824/2018 e datës 12.12.2018 e parashtruar nga ankuesi Tahir Hysenaj.

A r s y e t i m

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me datën 30.03.2018, ka nxjerr vendimin me të cilin i ka lejuar ankuesit Tahir Hysenaj, kompozimin e një pagë pas arritjes se moshës se pensionimin.

Ankuesi 19.07.2018, me numër protokolli 2738, ka paraqitur kërkesën tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë se Bujqërisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me arsyetimin se duhet ti bëhet kompensimin e pagave Jubilare për përudhen e kaluar, për dhjetë (10) vite, njëzet (20) vite dhe tridhjete (30) vite në shërbimin civil.

Drejtori i Drejtorisë se Administratës, i Agjencisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datën 23.07.2018, me numër protokolli 2762, i është përgjigjur ne kërkesën e ankuesit Tahir Hysenaj, me arsyetimin se në bazë të evidencës qe posedon Agjencia, ka konstatuar se ankuesi Tahir Hysenaj, ka filluar punën 02.02.2009, me të cilin nuk ka kaluar periudha prej dhjete (10) në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, për të realizuar ankuesi kompensimin e pagës.

Ankuesi Tahir Hysenaj, me datën 12.12.2018, për mes postes elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër protokolli 7589/2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 13.12.2018, me numër protokolli 7652/2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , ndërsa me datën 24.12.2018 me numër protokolli 7919/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësie, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 824/2018, e datës 12.12.2018, me numër protokolli 7589/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 19.07.2018; Vendim i datës 18.04.2018; Vërtetim i datës 06.02.2018; Vërtetim i datës 06.02.2018; vërtetim i datës 01.03.2018; Përgjigje në kërkesë e datës 23.07.2018; Lista e pagave; Vendimi i datës 30.03.2018 i Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; E-mailin e datës 23.07.2018; Përgjigje në ankesës e datës 19.12.2018 me numër protokolli 7919/2018, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses Tahir Hysenaj, ***është e pa lejuar, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar që ankuesi më datë 11.07.2018 ka parashtruar kërkesë për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila është protokolluar më datë 18.07.2018 me të cilin ka kërkuar kompensimin e 2 pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një pagë si shpërblim jubilar, dhe në këtë kuptim lidhur me pretendimin e ankuesit që nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që në bazë të provave të lëndës, ankuesi më datë 23.07.2018 nëpërmjet e-mailit ka pranuar përgjigjen e datës 23.07.2018 të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, në kuptim të kësaj nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kundër përgjigjes në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, në këtë kuptim ankuesi është dashur që para parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtroj fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë ashtu siç përcaktohet nenin 4 paragrafin 1 Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave dhe brenda afateve të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: ***"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës",*** pasi që fillimisht duhet shterë procedurat e brendshme të ankimit të përcaktuar me dispozitat e nenit 50 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: ***"Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike".***

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që ankesa e ankueses e datës 10.12.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: ***"Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshill..."*** dhe nenin 3 paragrafin 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: ***"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit...".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas shqyrtimit të lëndës, dhe bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Tahir Hysenaj;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësie;
- Arkivit të KPMSHCK-së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 824/2018.

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës